

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Festivali i 83-të i filmit në Venecia, 'Gruaja e panjohur' merr çmimin 'Luani i Artë' - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/festivali-i-83te-i-filmit-ne-venecia-gruaja-e-panjohur-merr-cmimin-luani-i-arte
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 20:21:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 13:33:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	638d927edb082fd4b849448fa686fc9a371460e8861fc14300eeaf944af26e2a
TEKSTI	dbec62a8cfc48573ad40829aa4382049d13686cb183886106fcd6aec4bcabe02
PAMJA	231f4ec86cd8a2032000e6be1d76840a7cd3e3db808e8aeab16e76b581fcc563

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	699b6b081f2f18cd610c62cdbabe03903e42bfcfb60ff2edf6411b096cefbe80
E MËPARSHMJA	4ee48542ad3d3773e20213ad06355812f6188a9659b629234745eeb7fd042fe8
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/699b6b081f2f18cd610c62cdbabe03903e42bfcfb60ff2edf6411b096cefbe80>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit




Protestuesit 5 net në shesh kundër vendimit të Hagës, 'skuqet' Prishtina! Shpaloset flamuri Kombëtar gjigant, kërkohet drejtësi për 4 ish-kreret e UÇK (VIDEO)

Kultura

Festivali i 83-të i filmit në Venecia, 'Gruaja e panjohur' merr çmimin 'Luani i Artë'

Festivali i 83-të i Filmit në Venecia është mbyllur mbrëmjen e së shtunës dhe si gjithmonë tërhoqi vëmendjen e shumë adhuruesve të kinematografisë nga e gjithë bota. Çmimin e Luanit të Artë e mori filmi Gruaja e Panjohur.



Blerina Gocë

13 Shtator, 15:28 | Përditësimi: 13 Shtator, 15:44

Share Tweet

A A

"Gruaja e panjohur" (Woman Unknown) i regjisores [May el-Toukhy](#) është fituesi i "Luanit të Artë" në edicionin e 83-të të Festivalit të Filmit në [Venecia](#).

Regjisoria egjiptiano-daneze ishte vetmja grua që drejtonte e vetme një film të metrazhit të gjatë në garëm kryesore (nga 21 filma në total), një detaj që ka ndezur diskutime gjatë gjithë javës mbi përfaqësimin gjinor në festival.

Filmi shënoi një sukses të dyfishtë, pasi përveç çmimit kryesor për filmin më të mirë, edhe aktorja kryesore Mathilde Arcel, mori kupën Volpi si aktorja më e mirë.



[Sh]
.com

LEXO EDHE:

Zv.presidenti i KE: Shqipëria e Mali i Zi në fazë të avancuar drejt anëtarësimit në BE! Zgjerimi i Unionit domosdoshmëri

Ngjarjet në film vendosen pak pas përfundimit të pushtimit nazist në Danimarkë. Historia ndjek një shërbëtoreshë të re e cila mban një sekret të madh dhe të errët, teksa përgatitet të martohet me punëdhënësin e saj shumë të pasur.

Kritikët e vlerësuan si një kryevepër të tensionit psikologjik. Filmi trajton me mjeshtëri fajin, mbijetesën, dinamikat e klasave dhe se sa larg mund të shkojë një njeri për të fshehur të kaluarën e tij në një shoqëri të thyer nga lufta.

Regjisori i njohur Ilya Khrzhanovsky mori çmimin për regjisorin më të mirë për filmin "DAU", ndërsa

aktori i njohur John Malkovich u vlerësua si aktori më i mirë i këtij viti për rolin e tij në "Kali i Egër Nëntë" (Wild Horse Nine).

Çmimi i Madh i Jurisë, Luani i Argjendtë shkoi për: "Dashuri e mundshme" (Possible Love) me regji të Lee Chang-dong (Kore e Jugut).

Skenari më i mirë: Stéphane Brizé, Coralie Amedeo dhe Olivier Gorce për filmin "Ushtari i vogël i mirë" (A Good Little Soldier) (Francë). Çmimi Special i Jurisë: shkoi për "Naza", dokumentar me regji të Yuval Abraham dhe Rachel Szor (Britani).

Aktori/Aktorja e re më e mirë (Çmimi Marcello Mastroianni) shkoi për Malou Khebizi për filmin "Një vend për t'u shëruar" (A Place To Heal) (Francë).

Luani i Artë për Karrierën u dorëzua për dy yjet e njohur, George Clooney dhe Ellen Burstyn. Kategoria Orizzonti (Filmi më i mirë): "Diane in the Loop" (Un détour par Diane) me regji të Ann Sirot dhe Raphaël Balboni.

Luani i së Ardhmes (Debutimi më i mirë): "Kali i erës" (House of the Ēind-La maison du vent) me regji të Auguste Bernard Kouemo Yanghu.

Nata finale e Festivalit të Filmit në Venecia 2026 dhuroi shumë emocione, momente historike dhe surpriza në tapetin e kuq të Sala Grande.

Festivali i 83-të i Filmit në Venecia u mbajt nga data 31 gusht deri më 12 shtator 2026 dhe u karakterizua nga një fokus tek temat e aktualitetit, sfidat shoqërore dhe filma pavarur që sfidojnë normat tradicionale të industrisë së filmit.

Xh.K/E.H/Shqiptarja.com

TAG: [venecia](#) [May el-Toukhy](#) [itali](#) [Festivali i Venecias](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull?



5.0 / 5 (2 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento



Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:

Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

16 Shtator, 14:18

Të drejtë

Të gabuar

Nuk e di

Lajme të tjera



'Fëmijët italianë nuk duhet të ndihen pakicë në klasat e tyre', Meloni paralajmëron rregulla të reja për shkollat në Itali: Kufij për numrin e nxënësve të huaj dhe ndalim të burkës

20 Shtator, 13:02



Itali/ Pronari kap hajdutët në shtëpi dhe hap zjarr, humb jetën 25 vjeçari, dyshohet se është shqiptar

20 Shtator, 12:43



Iu gjetën 400 kilogramë kanabis në frigorifer, arrestohet i riu shqiptar në Itali

19 Shtator, 20:45



Report Tv siguron foton e të riut nga Lezha që u ekzekutua në Itali, trupi i pajetë u gjet brenda një automjeti të hedhur në lumë



Venecia/ Po çonte vajzën 9-vjeçare në shkollë, 42-vjeçarja nga Durrësi përplaslet nga kamioni i plehrave, vdes para syve të së bijës (EMRI)



Grabitet shtëpia e kardinalit Ernest Simoni në Firence! Ndodhej në Londër për një takim me Mbretin Charles, hajdutët vjedhin sende me vlerë

18 Shtator, 20:10



Romë/ 13-vjeçari plagos mësuesen me thikë dhe tenton ta transmetojë sulmin live në Telegram! Shokët: Donte të hakmerrej për notën

18 Shtator, 16:10

18 Shtator, 19:54



Në kërkim për vrasje mbetur në tentativë dhe shitje të narkotikëve, pranga 2 shqiptarëve në Itali! Pritet ekstradimi (VIDEO)

18 Shtator, 11:47

30 mijë euro, bashkë me lejen e qëndrimit!

18 Shtator, 16:18



NATO përgatitet për skenarin ekstrem, qeveria italiane i druhet përshkallëzimit të konfliktit nga Moska: Sulm i mundshëm në fillim të 2027-ës

17 Shtator, 22:30



Shqipëria hap Konsullatë Nderi në Napoli, Rama: Italia është 'alter egoja' jonë europiane, ne jemi napolitanët e anës tjetër të detit (VIDEO)

16 Shtator, 08:10



Sadushi e Papajorgji priten në Itali nga Presidenti Mattarella: Sistemi i Drejtësisë në Shqipëri, partner i besueshëm në dialogun juridik ndërkombëtar!

15 Shtator, 20:56



Itali/ Senati miraton me 113 vota pro ndryshimet në kodin zgjedhor, pritet 'vula' e Dhomës së Deputetëve! Opozita proteston: Jo ligjit mashtrules!

15 Shtator, 15:53

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.